



Nr. 1607 Prot.
31.05.09.2017

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE TË ZONAVE TË MBROJTURA
DREJTORIA E MENAXHIMIT, PROJEKTEVE DHE MONITORIMIT

Nr. 922 prot.

Tiranë më, 31.08.2017

Lenda: Kthim përgjigje

Znj. NURIE DINAJ
ADMINISTRATOR
Shoqëria "DRAGOBIA ENERGY" sh.p.k
Njësia Bashkiake nr.2, Rruga "Papa Gjon Pali II",
Ndërtesa nr. 12, ABA Business Center, kati i 7-të teknik, Tiranë

Për dijeni:

Z. BESNIK HALLAÇI
DREJTOR
Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura, Kukës

Znj. DINAJ,

Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. 655 Prot., datë 08.06.2017 drejtuar Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, me lëndë "Dërgim i Planit të Rehabilitimit për projektin "Ndërtimi i HEC-ve në kaskadën e Dragobisë", ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Pasi u njohëm me Planin e Rehabilitimit dhe Studimin mbi Vegjetacionin, si kushte që vijnë nga përmbushja e kushteve të Lejes së Mjedisit me nr. 305 Prot., datë 23.07.2013 për projektin "Ndërtimi i HEC-ve në kaskadën e Dragobisë" si dhe faktit të pashmangshëm të fillimit të punimeve për realizimin e këtij projekti, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura si pjesë e konsultimeve që ka bërë, e shikon si tepër pozitiv procesin që ka filluar me zonat e përcaktuara për tu rehabilituar. Nga ana tjetër mendojmë se ka shume elementë dhe zona të tjera më emergjente që mund të jenë pjesë e masave rehabilituese që do të kenë efekt më imediat në komunitetin e zonës duke parë edhe mosdakortësinë që ka në zonë.

Gjatë punimeve rehabilituese, subjekti juaj duhet të bashkëpunojë me Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura, (AdZM) Kukës, për të bërë të mundur përfundimin me sukses të punimeve rehabilituese.

Faleminderit për mirëkuptimin,

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Zamir Dedej

Adresa: Rruga e Nobert Jokl (ish godina e ATSH), Tiranë




Departamenti i Mjedisit

Nr. Dokumenti: Document Nr:	Ge2_704 ESMS 01
Lloj Dokumenti: Document Type:	Plan
Titull Dokumenti: Document Title:	Plani i Rehabilitimit për Projektin "Ndërtimi i Hidrocentraleve në Kaskadën e Dragobisë"
Drejtoria Zoteruese: Directory Group:	Drejtoria e Standarteve
Revizioni: Revision:	0
Data e Krijimit: Issue Date:	30/05/2017
Data e Aprovimit: Approved Date:	03/05/2017

Revizioni Revision	Date Modifikimi Modification Date	Pershkrimi Modifikimi Modification Description	Kerkuar nga Requested by	Aprovuar nga Approved by
0				





Departamenti i Mjedisit

Nr. Dokumenti : Document Nr:	Ge2_704 ESMS 01
Lloj Dokumenti: Document Type:	Plan
Titull Dokumenti: Document Title:	Plani i Rehabilitimit për Projektin "Ndërtimi i Hidrocentraleve në Kaskadën e Dragobisë"
Drejtoria Zoteruese: Directory Group:	Drejtoria e Standarteve
Revizioni: Revision:	0
Data e Krijimit: Issue Date:	30/05/2017
Data e Aprovimit: Approved Date:	03/05/2017

Revizioni Revision	Date Modifikimi Modification Date	Pershkrimi Modifikimi Modification Description	Kerkuar nga Requested by	Aprovuar nga Approved by
0				



Baseni i presionit: Baseni i presionit i HEC-it të Dragobisë paraqet në vetvete një dhomë të vendosur para hyrjes së ujit në tubacionin e turbinave të këtij HEC-i dhe është projektuar i tillë që uji të futet në tubacionin e turbinave pa krijuar efekte të dëmshme, si futja e ajrit në tubacion dhe formimi i shtjellave brenda sistemit të tubacionit të turbinave, apo përballimi i efekteve të grushtit hidraulik gjatë mbylljes së turbinave. E thënë ndryshe, baseni i presionit i HEC-it të Dragobisë është një strukturë apo objekt nëntokësor, që krijon kushtet e përshtatëshme që uji të futet në tubacionin e turbinave pa fenomente të dëmshme që mund të ndikojnë negativisht në turbinat e HEC-eve. Për pasojë, volumi i basenit të presionit duhet të jetë i mjaftueshëm për të mos lejuar futjen e ajrit në tubacionin e turbinave si dhe për të përballuar me ujë kërkesat e krijuara nga një rritje e papritur e ngarkesës së turbinave, sidomos gjatë mbylljes së tyre.

Tubacioni i turbinave dhe kanali i largimit: Tubacioni i turbinave i HEC-it të Dragobisë paraqet në vetvete një tubacion çeliku që e përcjell ujin nën presionin nga baseni i presionit për te godina e hidrocentralit dhe më tej, pas daljes së ujit nga turbinat, nëpërmjet kanalit të largimit, uji derdhet përsëri në shtratin e lumit të Valbonës.







Figura 2-1 Përshkrimi i objekteve të HEC-it të Dragobisë në lumin e Valbonës

PLANIMETRIA E VENDOSJES VEPRË E MARRJES DRAGOBI, DEKANTUESI DHE KANALI I HYRJES

Sipërfaqja e prekur nga ndërtimi: S=10108m²




EMRI I PROJEKTIIT: Ndërtimi i HEC-ve në Dragobinë dhe Cerret në Lumën e Valbonës - Rrethi Tropojë		
ADRESA E PROJEKTIIT: Tropoje / Shqipëri		
POROSITËSI: "Dragobin Energy" sh.p.k		
HARTOJ: Ing. Tanush Caushi		
		
FAZA: PROJEKT ZBATIM		
Nr. i projektit:	7/10	
Data:		
		
GRUPI PROJEKTIIMIT: Grupi 2 Tanush Caushi		
Kontribuesi:	Kontribuesi	
Mirata:	Roland Shyti	
RISHIKIMET		
No.	Rev.	Data
00	Per zbatim	02/06/2017
Emri i Flites:		
PLANIMETRIA E VENDOSJES E VEPRËS SE MARRJES, DEKANTUESI DHE KANALI DRAGOBI		
Numri i Flites:		
I-01		
Shërbim:		

PLANIMETRIA E VENDOSJES SE GODINES HEC-DRAGOBI

Legjenda:

- Rruga per Godina HEC Dragobi
- Rruga kryesore
- Lumi

<p>EMRRI I PROJEKTI: Ndërtimi i HEC-ve të Dragobit dhe Centralit në Lumë të Valbonës - Rrethi Tropojë</p> <p>ADRESA E PROJEKTI: Tropoje / Shqipteri</p> <p>POROSITËSI: "Dragobit Energy" sh.p.a.</p> <p>HARTO: Ing. Tanush Caushi</p> <p>GENEPA</p> <p>FAZA: PROJEKT ZBATIM</p> <p>Nr./ Projekti: ... / ... / Zb. ...</p> <p>Data: ... / ... / ...</p>		<p>GRUPI I PROJEKTIMIT:</p> <p>Grupi 2: L.S.V.4.02.00.02</p> <p>Projekti: Tanush Caushi</p> <p>Kontrakti: Kontrakti Shqipëri</p> <p>Marrësi: Habori Shqipëri</p> <p>RISHIKIMET</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <th>No.</th> <th>Rev.</th> <th>Data</th> </tr> <tr> <td>00</td> <td>Per zbatim</td> <td>29/05/2017</td> </tr> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> </table> <p>Emri i Filet:</p> <p>PLANIMETRIA E VENDOSJES SE GODINES HEC-DRAGOBI</p> <p>Numeri i Filet:</p> <h1 style="font-size: 2em;">I-01</h1> <p>Shkalla:</p>	No.	Rev.	Data	00	Per zbatim	29/05/2017												
No.	Rev.	Data																		
00	Per zbatim	29/05/2017																		



Pika	Lista e Koordinatave dhe Siperfaqeve	
	X	Y
1	415963.576	4698755.845
2	415973.515	4698747.466
3	415937.793	4698725.264
4	415947.732	4698716.884
Sipefaqja e Godines		520 m²
Sipefaqja e rruges (Kufiri I Ndertimit		550 m²



2.2. Punimet E Ndërtimit Në HEC-In E Çeremit

Punimet inxhinierike civile në HEC-in e Çeremit, si hidrocentral i vogël përmban komponentët bazë të mëposhtëm: veprën e marrjes të ujit, dekantuesin, sistemin e derivacionit (tunelin), basenin e presionit, tubacionet e turbinave, godinën e HEC-it si dhe linjën e lidhjes elektrike të tij me rrjetin elektrik ekzistues.

Vepra e marrjes së ujit: lejon një rrjedhje të kontrolluar të ujit nga shtrati i përroit të Çeremit ku merret uji, duke e dërguar atë tek turbinat e hidrocentralit nëpërmjet sistemit të derivacionit (tunelit të këtij HEC-i) dhe tubacionit të turbinave .Një nga funksionet kryesore të veprës së marrjes të një HEC-i është edhe minimizimi i hyrjes së mbeturinave lundruese dhe të sedimenteve të sjella nga ana e ujit në hyrje të saj.


Dekantuesit: Këto struktura janë vendosur zakonisht pas veprave të marrjes dhe funksioni kryesor i tyre është kapja e sedimenteve me përmasa më të mëdha se 0.25 mm si dhe shpëlarja e tyre, duke mos lejuar në këtë mënyrë që këto sedimente të hyjnë në sistemin e derivacionit dhe tubacionit të turbinave dhe që mund të bëhen shkak për dëmtimin apo shkatërrimin e tyre. Sipas profilit gjatësor të dhënë në vizatimet përkatëse, dekantuesi i HEC-it të Çeremit fillon në progresivin 76.13m dhe përfundon në progresivin 138.63 m, përfshirë edhe pjesët rakorduese në hyrje dhe në dalje të dekantuesit.

Sistemi i derivacionit: Termi sistem i derivacionit nënkupton të gjithë përbërësit (objektet) e skemës së HEC-i që përdoren për të përcjellë ujë në distanca relativisht të mëdha nga vepra e marrjes para se uji të futet në tubacionet e turbinave. Në HEC-in e Çeremit sistemi i derivacionit përbëhet nga tuneli pa presion me gjatësi 2045m, i cili fillon nga progresivi 155 m dhe përfundon në progresivin 2,200 m (ku fillon baseni nëntokësor i presionit brenda tunelit).

Tuneli i derivacionit të HEC-it të Çeremit i parashikuar për tu ndërtuar për të transportuar ujin tranzit nga Dekantuesi i veprës së marrjes për tek baseni i presionit është një pjesë thelbësore e skemës së hidrocentralit të Çeremit dhe ndërtimi i tij është aplikimi i një nga teknikave më të mira të disponueshme për reduktimin e impakteve në mjedis krahasuar me instalimin e tubave përgjatë kanaleve që do duhej të hapeshin për instalimin e tubacionit, edhe pse kjo ka një kosto të konsiderueshme, duke zënë rreth 40 % të kostos totale të punimeve civile. Për këtë HEC ky tunel është projektuar me rrjedhje uji me sipërfaqe të lirë (pa presion), nën veprimin e forcës së rëndesës.

Baseni i presionit: Baseni i presionit i një HEC-i të vogël përfaqëson në vetvete dhoma të vendosura para hyrjes së ujit në tubacionit të turbinave dhe duhet të projektohet i tillë që uji të futet në tubacionin e turbinave pa krijuar efekte të dëmshme, si futja e ajrit në tubacion dhe formimi i shtjellave brënda sistemit të tubacionit të turbinave, apo përballimi i efekteve të grushtit hidraulik nga gjatë mbylljes së turbinave. E thënë ndryshe, baseni i presionit paraqet një strukturë apo objekt që krijon kushtet e përshtatëshme që uji të futet në tubacionin e turbinave pa fenomente të dëmshme që mund të ndikojnë negativisht në turbinat e HEC-it. Për rastin e basenit të presionit të HEC-it të Çeremit, ai është parashikuar të ndërtohet brënda në tunel, duke filluar në progresivin 2200 (aty ku përfundon tuneli i derivacionit).

PLANIMETRIA E VENDOSJES SE GODINES HEC-CEREM



Legjenda:

- Rruga per Godina HEC Cerem
- Rruga kryesore
- Lumi

Lista e Koordinatave dhe Siperfaqeve		
Pika	X	Y
1	412910.112	4700882.062
2	412923.275	4700878.66
3	412928.654	4700870.233
4	412926.332	4700856.825
5	412917.919	4700851.418
6	412901.699	Y = 4700876.655
Siperfaqja e Godines		391.6 m²
Siperfaqja e rruges (Kufiri I Nderimit)		522 m²

ENRITI PROJEKTI:
Ndërtimi i HEC-ve të Dragobisë dhe Ceremit në Lumën e Valbonës - Rrethi Tropojë

ADRESA E PROJEKTI:
Tropoje / Shqipëri

POROSITESI:
"Dragobit Energy" sh.p.k

HARTO:
Ing. Tanush Caushi

GENERA

PROJEKT ZBATIM

FAZA:

GRUPI PROJEKTIMIT:
Grupi 2
Tanush Caushi

RISHIKIMET

No.	Rev.	Data
00	Per raport	30/05/2017

Emri i Fildes:
PLANIMETRIA E VENDOSJES SE GODINES HEC-CEREM

Numri i Fildes:
I-01

Shekulli:

Tubacioni i turbinave dhe kanali i largimit: Tubacioni i turbinave i HEC-it të Çeremit do të përcjellë ujin nën presion nga baseni i presionit për te godina e hidrocentralit dhe më tej pas daljes së ujit nga turbinat e HEC-it, nëpërmjet kanalit të largimit, uji do të derdhet në shtratin e lumit të Valbonës, pranë bashkimit natyral të përroit të Çeremit me lumin e Valbonës. Tubacioni i turbinave i HEC-it të Çeremit do të ndërtohet me tub çeliku pjesërisht brenda në tunel (Fundi i basenit të presionit në progresivin 2200 m deri te progresivi 2547.4 m dhe pjesërisht si tubacion çeliku i futur në tokë (progresivi 2547.4 m deri te godina e centralit në progresivin 3026 m).

SKEMA E PËRGJITHSHME E SHFRYZIMIT ENERGETIK
HEC ÇEREM & DRAGOBI




Figura 2-2:Skema e HEC -Çeremit

2.3. Metodologjia e Hartimit të Planit të Rehabilitimit

Hartimi dhe përpilimi i Planit të Rehabilitimit ka marrë në konsideratë situatën aktuale mjedisore para fillimit të punimeve për ndërtimin e HEC –eve ,duke u konsultuar me të gjithë dokumentacionin e nevojshem teknik të përpiluar nga grupet studimore për një aktivitet sa më të qëndrueshëm dhe miqësor me mjedisin.Janë hartuar inspektime në cdo shesh apo segment para fillimit të punimeve ndërtimore .



Është evidentuar paraprakisht lloji i vegjetacionit për të shmangur dëmtimin e ndonjë specie të mbrojtur sipas listës së "Red book".Llojet e rrezikuara janë evidentuar dhe janë njohur nga stafi në terren paraprakisht duke shmangur dëmtimin e tyre .¹

Janë parashikuar volumet e pritshme të gjermimeve të materialit natyrorë të gjeneruar nga proceset e gjermimit .

Janë evidentuar zonat ku janë bërë punimet për rrugë aksesi,sheshe për hapje tuneli apo ndërtimin e godinave të Hec-eve , për të cilat ka nevojë të kryhen punime rehabilitimi , kryesisht në skarpata ,për të shmangur erozionin natyror,përmisuar pamjen visuelle,për të qënë në harmoni me zonën përreth . Janë inspektuar dhe evidentuar zonat me problematikë të trashëguar ndaj erozionit natyror brenda parkut ,por edhe në afërsi me zonën e projektit , zonat e dëmtuara nga faktori antropogjen (nga shfrytëzim i parkut për material inert nga subjekte të tjera gjatë ndërtimit të rrugës nacionale Bajram Curri –Valbonë) , kërkesat e përdoruesëve tradicionalë të cilët kanë probleme të shkaktuara nga erozioni natyror, për të mundësuar rehabilitimin e këtyre zonave dhe njëkohësisht për të përdorur në mënyre eficente materialin e gjeneruar nga proceset e gjermimeve ,si dhe si kontribut për mbrojtjen e natyrës ,mjedisit dhe për komunitetin e zonës .

2.4. Materiali i gjeneruar nga proceset ndërtimore

Gjatë aktivitetit për hapjen e rrugëve të aksesit ,godinave,veprave të marrjes ,hapjen e tuneleve,do të kemi kryesisht punime gjermimi të konsiderueshëm,si pasojë do kemi gjenerim të dherave (material i ngurtë natyror) , dëmtim të vegjetacionit ,mbushje me cakull dhe shtrime me gur natyror të rrugëve të aksesit .

Sasia e llogaritur e pritshme e materialit të gjeneruar (dhera,gurë)deri në mbyllje të fazës së ndërtimeve,është afërsisht deri në 100 000 m³ .

2.5. Udhëzime mbi Rehabilitimin

Sipas Udhëzimit Nr.3;dt.17.05.2006 "Për planet e rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara ", rehabilitimi përfshin të gjitha ato masa të cilat synojnë të riparojnë tokën e shqetësuar ose degraduar dhe t'i kthejnë këto toka në një gjëndje të qëndrueshme dhe të pandotur që është e përshtatshme për të ardhmen e tokës.

Synimet kryesore të punës rehabilituese janë :

- Të arrihet një stabilizim i zonave të dëmtuara për të minimizuar erozionin natyror që vazhdon.
- Të rimbulojë të gjitha zonat ku janë kryer më parë punime për marrjen e materialeve për lëndë të parë,me specie të përshtatshme drunore dhe bimore.
- Të zgjedhë bimësinë në përputhje me florën dhe klimën e zonës.
- Të minimizojë ndikimin pamor të zonave të shqetsuara.
- Të përdor materialin e gjeneruar nga gjermimet për qëllime rehabilitimi.
- Të përmbushë kushtet e lejes së mjedisit.
- Të jetë në komplaincë me kuadrin ligjor institucional.

¹ Referuar studimit mbi llojin e vegjetacionit potencialisht të dëmtuar nga punimet ndërtimore Prof.Dr.Arsen Proko.

3. Impaktet Potenciale Nga Faza Ndërtimore.

Padiskutim që zhvillimi i një aktiviteti apo zhvillimi i një projekti, shkakton mbi mjedisin një impakt, qoftë ky pozitiv apo negativ. Në këtë kuptim, impakti shikohet si diferencë midis ndryshimeve dhe zhvillimeve para fillimit të projektit në lidhje me ndryshimet dhe zhvillimet që ndodhin pas fillimit të projektit. Kështu edhe në zhvillimin e projektit për ndërtimin dhe funksionimin e HEC Dragobia kemi ndikime të pritshme mbi mjedisin, të cilat shoqërojnë procesin e ndërtimit të HEC-eve.

I rëndësishëm mbetet fakti që qysh në hartimin e këtij projekti impaktet evidentohen me synim marrjen e masave për zbutjen apo minimizimin e atyre negative. Kështu më konkretisht disa nga këto impakte apo ndikime mund të përmendim:

3.1. Faza Ndërtimore:

Gjatë kësaj faze kemi keto impakte :

- Ndryshim të peisazhit nga punimet e gërmimit për hapjen e rrugëve të aksesit , ndërtimin e veprave të marrjes ,ndërtimin e godinave të HEC-eve dhe tuneleve.
- Emetime zhurmash.
- Emetime grimca të ngurta në ajër (pluhura).
- Gjenerim sasive e konsiderueshme e dherave, gurë të cilat duhet të depozitohen në sheshe apo përdoren për procese rehabilitimi ,apo për rrugët e aksesit.
- Dëmtim i vegjetacionit
- Ndikimi në peisazh; ndikimi vizual gjatë ndërtimit të HEC –eve , perfshi punimet e gërmimit për ndërtimin e godinave , rrugëve të aksesit ,tuneleve cila mund të rivendoset dhe të permiresohet me pyllzime për të ulur impaktet vizive jo të pranueshme që shkakton prania e gërmimeve dhe e ngjyrave jashtë të gjelbrës dhe atyre afer saj nga keto gërmime, duke i permiresuar drejt gjelberimit nepermjet masave biologjike me ribarezime dhe rimbjellje druresh e shkurresh aty ku ky është zhveshur nga vegjetacioni bimor. Gjatë fazës së ndërtimeve , kantieri rrethohet me rrjetë të gjelbër jo vetëm për të kufizuar zonën e punës , por edhe për të reduktuar impaktin vizual në zonën e ndërtimit .

3.2. Masat Zbutëse të Rekomanduara dhe Zbatuara

Për reduktimin e impakteve të pritshme në mjedis ,Dragobia Energy zbaton një sistem menaxhimi të mjedisit ISO14001. Lidhur me të ajo ka procedurat e saja të cialt ndiqen rregullisht nga stafi i mjedisit në terren ,për të garantuar që niveli i shkarkimeve në mjedis të jetë brënda limiteve të caktuara sipas normave ligjore, për të reduktuar impaktet e pritshme mbetëse dhe për të përmbushur të gjitha kërkesat e kushteve të lejes mjedisore. Masat kryesore zbutëse të rekomanduara dhe zbatuara janë:

- Lagia e terrenit në zonën e punimeve për të reduktuar nivelin e grimcave të ngurta në ajër.
- Rrethimi i zonës së punës me rrjetë jeshile.
- Aplikimi i TMD, dhe konkretisht alternativa duke hapur 2 tunele me afërsisht 5 km në total, e cila edhe pse rrit shumë më shumë koston e ndërtimit të këtij projekti , krahasuar me futjen e tubacionit në kanal ,është zgjidhja më e mirë për reduktimin në maksimal të impakteve të pritshme. Nëse do futej tubi në kanal (dhe jo në tunel sic po ndërtohet) , impakti në mjedis do ishte më i lartë .
- Monitorimi i cilësisë së mjedisit nëpërmjet laboratorëve të akredituar.

- Rehabilitimi i zonës së ndikuar sipas planeve të rehabilitimit.
- Implementimi i Planit të Menaxhimit të Mjedisit .

4. Gjendja E Mjedisit Para Fillimit Të Punimeve Ndërtimore

Para fillimit të punimeve ndërtimore gjatë muajve Shkurt - Mars të vitit 2016 është realizuar një inspektim në të gjithë zonën e projektit për të evidentuar situatën aktuale dhe problematikat egzistuese brenda parkut kombëtar në afërsi me zonën e projektit .

Lehtësisht janë evidentuar probleme të erozionit natyror kryesisht në anët e rrugëve brenda parkut por edhe përgjatë brigjeve të Valbonës të shkaktuara këto nga fenomene natyrore.

Fotot në vijim paraqesin pamje nga inspektimi para fillimit të punimeve .





Figura 4-1 Pamje të fenomenit të erozionit natyror para fillimit të punimeve ndërtimore ,Shkur-Mars 2016 bregu i Valbonës



Figura 4-2: Pamje nga erozioni natyror në livadhin e Zekës, përroi i Ceremit ,Maj 2017

Këtyre fenomeneve të erozionit natyror ndërvite ,i shtohen edhe problemet e shkaktuara nga faktori antropogjen. Për shkak të shfrytëzimit për material inert nga subjekte të tjera ,disa vite më parë, gjatë ndërtimit të rrugës nacionale Bajram Curri –Valbonë , janë krijuar zgarva dhe gropa të pa rehabilituara më pas nga këto subjekte .

Fotot në vijim paraqesin problemet e trashëguara të erozionit nga faktori antropogjen në afërsi me zonën e projektit të HEC.



Figura 4-3: Pamje nga zona e shfrytëzuar nga subjektet që kanë marrë gurë për ndërtimin e rrugës BC-Valbonë Grykë derdhja e përroit të Petishit, vendi Dragobi, lagja Sokolaj.



Figura 4-4: Pamje nga vendi i shfrytëzimit të marrjes së gurit për ndërtimin e rrugës BC-Valbonë, Klysyre ish pika e nxjerrjes së inerteve

5. Cfarë Planifikohet të Rehabilitohet ?

Kompania ka marrë në konsideratë të rehabilitojë :

- Zonat ku janë bërë punimet për rrugë aksesi, sheshe për hapje tuneli apo ndërtimin e godinave të Hec-eve , për të cilat ka nevojë të kryhen punime rehabilitimi , kryesisht në skarpata ,për të shmangur erozionin natyror, përmisuar pamjen visuelle, për të qënë në harmoni me zonën përreth . Këto janë detyrimet për shkak të operacioneve ndërtimore dhe në përputhje me kushtet e lejes së mjedisit.

Është llogaritur që totali i sipërfaqes së skarpatave të krijuara nga të gjitha proceset ndërtimore është rreth 10000 m² .Kjo sipërfaqe do të rimbillet me bar apo fidanë të llojit të sygjeruar nga eksperti i vlerësimit të vegjetacionit sipas zonave .²

Këto skarpata gjenden pranë :

Sheshit të në dalje Dragobi

Sheshit të tunelit në hyrje Cerem

Skrapatat pranë rrugëve të aksesit .

- Zona të eroduar nga shkaqe natyrore dhe antropogjene në afërsi me zonën e punimeve ndërtimore ,për të cilat do të përdoret masa e dherave ,gurëve natyrorë të gjeneruar nga proceset e gërmimeve për rrugët e aksesit , shpime të tuneleve.Edhe pse këto rehabilitime nuk janë detyrime ligjore të kompanisë ndërtuese,janë marrë përsipër të kryhen me koston e kompanisë si pjese e politikave të kompanisë për ruajtjen e mjedisit, përdorimin efciente të burimeve natyrore (masa e dherave ,gurët e gjeneruara nga punimet ndërtimore) dhe rritjes së performancës mjedisore të saj.Këto operacione janë gjithashtu edhe si pjesë e politikave sociale që kompania implementon. Sheshet e planifikuara për tu rehabilituar si kontribut i kompanisë por edhe si zgjidhje teknike për të depozituar materialin natyror të gjeneruar (dhera ,gurë) lidhur me sa më sipër janë :

- Grykë derdhja e përroit të Petishit,vendi Dragobi,lagjja Sokolaj.
- Rehabilitimi me gabion i tubit të ujësjesit të Bajram Currit me gjatësi rreth 35 ml, i cili ndodhet tek përroji i Petishit (Si ndihmë për Ujësjellësin).
- Sistemimi i rrjedhës së Përroit të Ceremit për të penguar erozionin natyror në brigjet e

² Referoju Raportit të Vlerësimit të Vegjetacionit në Zonën e Projektit ,potencialisht të ndikuar nga procesi i ndërtimit të HEC Cerem dhe Dragobi

përroit tek Livadhi i Zekës.

- Grykë derdhja e përroit të Kikajë në lumin Valbonë, vendi Mbaskollate, nëpërmjet depozitimit të materialit të dherave dhe gurëve të dala nga proceset e gërmimit.

Ndërkoh nësë edhe pas përdorimit për rehabilitimet e mësipërme do mbetet përsëri material i gjeneruar nga gërmimet (dhera ,gurë natyrore), i cili do duhet të depozitohet ,kompania do marrë në konsideratë rehabilitimin e gropës së hapur nga shfrytëzimi për inerte (nga kompanitë e tjera) që ndodhet në anë të rrugës nacionale BC _Valbonë , anë të djathtë të saj dhe që njihet me emrin :

- Klysyre (ish pika e nxjerrjes së inerteve për ndërtimin e rrugës BC _Valbonë ,që i korrespondon sipas emërtimeve të projektit Dalje Dragobi)

Pamje të këtyre zonave janë prezantuar në fotot e mësipërme ,referoju kap.4.Gjendja E Mjedisit Para Fillimit Të Punimeve Ndërtimore.

6. Përshkrim i Vegjetacionit në Zonën e Projektit Potencialisht e Ndikuar nga Ndërtimet, si dhe tek Sheshet e Rehabilitimit ³.

6.1. Të Dhena Të Përgjithshme Mbi Zonën E Studimit

Në zonën e projektit vihen re probleme natyrore të trashëguara të erozionit si përgjatë brigjeve të përroit të Çerçemit, lumit të Valbonës por edhe për shkaqe njerëzore nga shfrytëzimi për material inert (nga subjekte të ndryshme) për ndërtimin e aksit nacional automobilistik Bajram Curri -Valbone, dhe shmangien e rehabilitimit më pas prej tyre të zonës së shfrytëzuar .

Inspektimet mbi vegjetacionin janë përqendruar në të gjithë zonën e projektit përfshirë edhe pikat e mëposhtme:

- Grykë derdhja e përroit të Petishit, vendi Dragobi, lagja Sokolaj. Sheshi i depozitimit x: 417663.86E; y: 4697527.22N; z: 494 m mbi nivelin e detit. Rehabilitim nëpërmjet depozitimit të materialit të ngurte natyror (dhera , gure) të sheshit tek
- Grykë derdhja e përroit të Kikaje në lumin Valbonë, vendi Mbaskollate
- Klysyre ish pika e nxjerrjes së inerteve për ndërtimin e rrugës
- Përroi i Çeremit ,tek Livadhi i Zekës.
- Vepra e marrjes dhe sheshi tek hyrja e tunelit Dragobi; x: 413540.74E; y: 4700123.76N; z: 667 m mbi nivelin e detit
- Pika e daljes se tunelit Dragobi dhe rruga e aksesit; x: 415631.84E; z: 4699015.10N; z: 662 m mbi nivelin e detit.
- Vepër e marrjes dhe hyrje e tunelit te Çerremit dhe rruga e aksesit; x: 414576.94E; y: 4702721.00N; z: 1040 m mbi nivelin e detit
- Pika e daljes se tunelit te Çerremit dhe rruga e aksesit; x: 412698.20E; y: 4701523.20N; z: 931 m mbi nivelin e detit
- Pika e Aksesit te tunelit Dragobi
- Vendi ku do te ndërtohet godinat e HEC Cerem dhe Dragobi
- Rehabilitimi me gabion i tubit te ujesjellesit te B.C me gjatesi rreth 35 ml, i cili ndodhet tek përroji i Petishit(si ndihmë për ujësjellsin dhe komunitetin)

³ Studimii hartuar nga Prof.Dr Arsen Proko

6.2. Mbulesa E Tokës

Përcaktimi i mbulesës së tokës përbën një element të rëndësishëm për raportimin kombëtar e ndërkombëtar. Mbulesa e tokës përcaktohet mbi bazën e kombinimit të faktorëve ekologjikë dhe mënyrës së përdorimit të tokës. Mbulesa e tokës sipas klasifikimit FAO-LCCS3 është një sistem hierarkik dikotomik.

Më poshtë po japim pjesën e sistemit që koordinon me zonën e rilevuar gjatë vëzhgimit tonë:




Figura 6-1 Skema e klasifikimit të mbulesës së tokës

6.3. Tipi i Pyllit

Një tjetër klasifikim i mbulesës bimore që përdoret gjatë proceseve të monitorimit e vlerësimit është klasifikimi në tip pyjesh sipas Forest Europe. Ky klasifikim është më tepër ekologjik dhe jep informacion mbi faktorët ekologjikë optimale ku zhvillohet pylli. Përcaktimi i tipit të pyllit bën më të lehtë përzgjedhjen e specieve që do të përdoren për rehabilitimin e terreneve të prekura/dëmtuara nga ndërtimi i HEC-eve.

Përcaktimi i tipit të pyllit sipas sistemit të sipër-përmendur jep informacion edhe për shkallën e zhvillimit dinamik të ekosistemeve si dhe lidhjen e tyre brenda serive vegjetacionale. Për më tepër informacion shihni në përshkrimin e çdo tipi pylli në kapitullin mbi rezultatet.

Skema e klasifikimit të pyjeve, me kodet respektive, që ndodhen në zonën e aktiviteteve sipas Forest Europe jepet më poshtë:




Figura 6-2 Sistemi i klasifikimit te tipave te pyjeve sipas FAO-EFI (Forest Europe)

6.4. Metoda E Studimit

Për evidentimin e nivelit të prekjes së vegjetacionit, për shkak të punimeve për ndërtimin e HEC-eve Çerrem-Dragobi jemi mbështetur në metodën klasike eko-fitosociologjike.

Njësia e vrojtimit ka qenë rilevimi me sipërfaqe përcaktuar me metodën e "arealit minimum". Areali minimum është njësia më e vogël e sipërfaqes që manifeston të gjitha karakteristikat e vegjetacionit. Sipërfaqja e rilevimit, sipas provave të marra, rezultoi rreth 400m² ose një rreth me reze 11.28 m.

Grupi sipërfaqeve provë (tufa) përbëhet nga pesë sipërfaqe provë, një sipërfaqe kryesore (qendrore), e cila u vendos në afërsi të zonës së punës (zona e prekur) dhe katër sipërfaqe provë satelitore në një distancë prej 100m nga qendra e sipërfaqes qendrore. Në këtë mënyrë patëm mundësi të krahasonim gjendjen e vegjetacionit në zonën e aktivitetit dhe jashtë saj. Më poshtë paraqitet skema e tufës:




Figura 6-3Vendosja e sipërfaqeve prove ne tufa

Në çdo pikë të aktivitetit për ndërtimin e HEC Çerrem-Valbone u vendos një tufë. Për çdo sipërfaqe provë (rilevim) u plotësua një skedë rilevimi tip, ku në pjesën e parë u regjistruan të dhëna të



përgjithshme gjeo-morfologjike ndërsa në pjesën e dytë u vendos inventari i të gjitha bimëve përfshi formën biologjike dhe korologjike.

Bazuar në formën biologjike të specieve dhe atë korologjike janë përllogaritur Spektri Biologjik dhe Spektri Korologjik, mjaft të rëndësishëm për përzgjedhjen e llojeve që do të përdoren në planin e rehabilitimit.

6.5. Rezultatet e Vlerësimit

Nga vërtetimet në terren dhe përpunimi i tyre në zyrë rezultoi si më poshtë:

6.5.1. Grykë derdhja e përroit të Petishit, Dragobi _lagjja Sokolaj

Punimet konsistojnë në depozitim të materialeve natyrore dhe, gurë që dalin nga punimet e gërmimit për hapjen e tuneleve dhe mbushja me dhëra /tokë në një sipërfaqe prej rreth 1 ha x 1m, të zgavrës së hapur (gropë) nga shfrytëzimi i materialit për inerte nga kompani gjatë ndërtimit të rrugës kombëtare Bajram Curri –Valbonë. Kjo zonë tashmë rrezikohet nga probleme të erozionit natyror. Sistemi i përroit dhe pyllëzimi i sheshit pas depozitimit të materialit.

Vegetacioni në afërsi dhe përreth zonës ku do depozitohet materiali (dhëra , gurë) përfaqëson një formacion shkurror të degraduar, për shkak të kullotjes intensive dhe ndikimit gjërryes të përroit. Dominohet nga shkoza e zezë (*Carpinus orientalis* Miller.), shoqëruar nga Dëllinja e kuqe (*Juniperus oxycedrus* L.), Mëlleza (*Ostrya carpinifolia* Scop.), Frashri i bardhë (*Fraxinus ornus* L.), Trëndafili i egër (*Rosa canina* L.), Murrizi njëbërthamësh (*Crataegus monogyna* Jacq.) etj. Përfaqëson një vegetacion pyjor të zonës altitudinale me klimë të temperuar, karakterizuar nga një periudhë pushimi vegetativ në dimër dhe një periudhë zhvillimi veror (*Aestilignosa* sipas Brockmann-Jerosch) dhe prania e një nënpylli floristikisht të pasur dhe të diferencuar (shih tabelen).

Për sa i përket mbulesës së tokës klasifikohet në kategorinë e pyjeve dhe sipërfaqeve gjysmë-natyrore, nën-kategorinë shkurre (tranzicionale). Tipi i pyllit është ai i pyjeve të tjerë termofile gjëtherënës.

Nga pikëpamja dinamike përfaqëson stadin e tretë të degradimit të serisë vegetacionale të pyjeve termofile gjëtherënës. Shkaku i degradimit është kullotja intensive dhe prerjet e druve të zjarrit për nevojat e popullsisë lokale. Bio indikatorët e kullotjes janë speciet espineshente: Trëndafili i egër (*Rosa canina* L.), Murrizi njëbërthamësh (*Crataegus monogyna* Jacq.), Dëllinjes së kuqe (*Juniperus oxycedrus* L.) si dhe prania e Kemashen vashmiu (*Hieracium pilosella* L.). Dëmtime gjithashtu vijnë nga efektet gjërryese në shpatet e Përroit të Milloshit. Si bio-indikatorë do përmendim praninë e Stehelines njelulore (*Staelina uniflosculosa* Sibth. & Sm.) dhe Thundermushkes (*Tussilago farfara* L.)

Ndërkohë sic mund të vërehet edhe nga fotot , zona ku do rehabilitohet është totalisht e zhveshur nga bimësia për shkak të materialit të marrë për shfrytëzim për inerte nga subjektet e tjera të cilat nuk e kanë rehabilituar atë . Zona ku do hidhen materiali është totalisht pa bimësi që nga koha kur është shfrytëzuar prej subjeteve për ndërtimin e rrugës nacionale.



Figura 6-4 Grykë derdhja e përroit të Petishit _ Dragobi, lagjja Sokolaj

Lista e specieve të cilat gjenden në afërsi me zonën ku do depozitohen dherat dhe guret e gjeneruara nga proceset e gjurmimeve, me formën biologjike, korologjike dhe statusin e përdorimit jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 6-1: Pyje te tjere termofile gjetherenes (ne afersi me Grykë derdhja e përroit të Petishit _ Dragobi) Sokolaj

Pyje te tjere termofile gjetherenes (ne afersi me Grykë derdhja e përroit të Petishit _ Dragobi) Sokolaj				
Nr.	Emri i species	Forma Biologjike	Forma korologjike	Statusi
1	<i>Ostrya carpinifolia</i> Scop. (Melleza)	Ph	Circumbor	
2	<i>Carpinus orientalis</i> Miller. (Skoza e zeze)	Ph	Pontic	
3	<i>Fraxinus ornus</i> L. (Frasheri I bardhe)	Ph	Eumed	
4	<i>Juglans regia</i> L. (Arra)	Ph	EuAsia	Frutor- mjekesor Kat. En- IUCN
5	<i>Pteridium aquilinum</i> (L) Kuhn (Fiershqipja)	G	Kozm	
6	<i>Satureja montana</i> L. (Trumza)	Ch	MedP	Mjekesore Kat. E- IUCN
7	<i>Stæhelinea uniflosculosa</i> Sibth. & Sm. (Steheline njelulore)	Ch	Balk	
8	<i>Teucrium chamaedrys</i> L. (Arrs fletedushk)	Ch	EuMed	
9	<i>Sedum album</i> L. (Rrushqyqe e bardhe)	H	EuMed	
10	<i>Hieracium pilosella</i> L. (Kemashen vashmiu)	H	EuKaukaz	
11	<i>Juniperus oxycedrus</i> L. (Dellinje e kuqe)	Ph	SubBalk	Mjekesore Kat. Vu A1b
12	<i>Euphorbia myrsinites</i> L. (Riell I mirsinit)	G	EuPont	
13	<i>Helianthemum nummularium</i> (L.) Miller. (Heliantheme sarafi)	Ch	EuKaukaz	

14	Ranunculus silvestris (Julin) S. Ericsson (Zhabina e pyllit)	T	Eumed	
15	Thymus longicaulis C. Presl. (Lister kercellgjate)	H	Eumed	Mjekesore
16	Lotus corniculatus L. (Thuapule brinoke)	G	Paleotemp	
17	Sanguisorba minor Scop. (Sanguisorbe me e vogel)	H	EuAsia	
18	Geranium robertianum L. (Barbaroz)	T	SubCosm	
19	Tussilago farfara L. (Thundermushka)	G	Paleotemp	Mjekesore
20	Trifolium montanum L. (Terfili i maleve)	H	EuPont	
21	Cirsium vulgare (Savi) Ten. (Gjembi i rendomte)	H	Paleotemp	
22	Crataegus monogyna Jacq. (Murrizi njeberthamesh)	Ph	Paleotemp	Mjekesore
23	Rosa canina L. (Trendafil i eger)	Ph	EuAsia	Mjekesore
24	Rubus canescens DC. (Manafera e perhime)	Ph	MedV	Frutor- mjekesor
25	Helleborus odoratus Ęaldst et Kit. (Shpender)	G	EuJL	
26	Primula vulgaris Hudson. (Agulice e rendomte)	H	EuKaukaz	
27	Brachypodium sylvaticum (Hudson) P. Beauv. (Rudith pyjesh)	H	Paleotemp	
28	Poa bulbosa L. (Flokez qepore)	H	Paleotemp	
29	Viola odorata L. (Manushaqe eremire)	H	Eumed	

Por sic u theksua edhe më sipër në zonën ku do hidhen dherat nuk ka snje lloj bimësie (është dukshëm një zgarvë e zhveshur nga cdo lloj bimësie).

Faktorët e Ellenbergut janë bio-indikatorë që tregojnë për kërkesat ekologjike të specieve për tre tregues klimatikë (drita-L, temperatura-T, Kontinentaliteti-K) dhe tre tokësorë (Lagëeshtia-M, pH-R, Pjelloria-N). Faktoret e Ellenbergut japin informacion për mikro-klimën e mikro-tipin e tokës ku rriten ato bimë. Përcaktimi i gjashtë treguesve ekologjike është një element i rëndësishëm për përzgjedhjen e specieve për rehabilitim

Bazuar në pesë speciet kryesore të këtij formacioni bimor faktorët e Ellenbergut rezultojnë si në grafikun e mëposhtëm:




Figura 6-5 Faktorët e Ellenbergut (Grykë derdhja e përroit të Petishit, vendi Dragobi, lagja Sokolaj)

6.5.2. Grykë derdhja e përroit të Kikaje në lumin Valbonë, vendi Mbaskollate

Punimet konsistojnë në ndërtimin e një rruge aksesi deri tek hyrja e tunelit dhe shesh depozitimi në posedim të përdoruesve tradicionale për grumbullimin dhe depozitimin e materialeve natyrore (dhëra , gurë)që dalin nga tuneli.

Punimet konsistojnë në ndërtimin e një rruge aksesi deri tek hyrja e tunelit dhe shesh depozitimi në posedim të përdoruesve tradicionale për grumbullimin dhe depozitimin e materialeve natyrore (dhëra , gurë)që dalin nga tuneli.

Nga pozicioni morfologjik i terrenit ku vendoset (buzë brigjeve të Lumit Valbonë) i përket tipit të vegjetacionit të tokave të lagura, nën-tipit të pyjeve të shtretërve të lumenjve (LCSS3) ose pyjeve fluviale (Forest Europe).

Këto lloj formacionesh bimore vendosen buzë ujërave të rrëmbyeshëm të Lumit të Valbonës por arrijnë deri në buzë të pjerrësive përreth.

Përfaqësojnë pyje gjethegjera të lokalizuara gjithmonë në vende të lagura. Vërriu dhe shelgjet janë speciet dominuese të këtij formacioni, të cilat janë të afta të kolonizojnë këto toka të pasura, si mbulesë e përhershme bimore. Në këtë aspekt aciditeti dhe niveli i oksigjenit përcakton specien dominuese të formacionit. Ky është një element shumë i rëndësishëm që duhet patur në konsideratë në përzgjedhjen e specieve rehabilituese. Ky tip formacioni dominohet nga një specie e vetme. Speciet shkurre janë gjithashtu të kufizuara, ndërsa shtresa gjysëm-shkurre dhe barishtore paraqitet e pasur në specie. Pamja e përgjithshme në zonën e vrojtimit paraqitet në foton e mëposhtme:



Figura 6-6Grykë derdhja e përroit të Kikaje në lumin Valbonë, vendi Mbaskollate

Lista llojore paraqitet më poshtë:

Tabela 6-2 Grykë derdhja e përroit të Kikaje në lumin Valbonë, vendi Mbaskollate

Grykë derdhja e përroit të Kikaje në lumin Valbonë, vendi Mbaskollate				
Nr.	Emri i species	Forma Biologjike	Forma korologjike	Statusi
1	<i>Alnus incana</i> (L.) Moench. (Verri I bardhe)	Ph	CircumBor	
2	<i>Salix eleagnos</i> Scop. (Shelgu I zi)	Ph	EuJ	
3	<i>Aruncus dioicus</i> (Ëalter) Fernald (Arunke dioike)	H	CircumBor	

4	<i>Salix caprea</i> L. (Shelgu i eger)	Ph	Paleotemp
5	<i>Equisetum telmateia</i> Ehrh. (Keputje e madhe)	H	CircumBor
6	<i>Carex pallescens</i> L. (Presje e zbehte)	H	CircumBor
7	<i>Calamagrostis pseudophragmites</i> (Hallar fil.) Koeler (kallam si kallmishte)	H	EuSiber
8	<i>Stellaria nemorum</i> L. (Stelarie pyjesh)	H	EuKaukaz
9	<i>Solanum dulcamara</i> L. (Solane e embel)	Ph	Paleotemp
10	<i>Nasturtium officinale</i> R. Br. (Purgjak)	H	Kozmop
11	<i>Mentha aquatica</i> L. (Mender uji)	H	Paleotemp
12	<i>Epilobium palustre</i>	H	CircumBor

Nga speciet e inventarizuara ne këtë zone nuk rezultuan specie me status te rrezikuar, sipas listes se kuqe

Bazuar në bio-indikatorët e Ellenbergut, duke marrë pesë speciet më përfaqësuese është marrë grafiku i mëposhtëm, i cili përcakton tre faktorët klimatike dhe tre faktorët edafike të vendit




Figura 6-7Faktorët e Ellenbergut: Sheshi i depozitimit, Tuneli i hyrjes Dragobi

6.5.3. Tuneli i daljes Dragobi

Punimet në këtë pikë konsistojnë në hapjen e një rruge aksesi dhe pikën e daljes së tunelit të Dragobisë.

Vegjetacioni përfaqëson një formacion shkurror të degraduar, për shkak të kullotjes intensive dhe ndikimit gërryes të përroit. Dominohet nga shkoza e zezë (*Carpinus orientalis* Miller.), shoqëruar nga Dëllinja e kuqe (*Juniperus oxycedrus* L.), Mëlleza (*Ostrya carpinifolia* Scop.), Frashri i bardhë (*Fraxinus ornus* L.), Trëndafili i egër (*Rosa canina* L.), Murrizi njëbërthamësh (*Crataegus monogyna* Jacq.) etj. Përfaqëson një vegjetacion pyjor të zonës altitudinale me klimë të temperuar, karakterizuar nga një periudhë pushimi vegjetativ në dimër dhe një periudhë zhvillimi veror (Aestilignosa sipas Brockmann-Jerosch) dhe prania e një nënpylli floristikisht të pasur dhe të diferencuar (shih tabelën). Për sa i përket mbulesës se tokës klasifikohet në kategorinë e pyjeve dhe sipërfaqeve gjysmë-natyrore, nën-kategorinë shkurre (tranzicionale). Tipi i pyllit është ai i pyjeve të tjerë termofile gjetherënës.

Vegjetacioni përfaqëson stadin e trete të degradimit të serisë së pyjeve termofile, dominuar nga Shkoza e zezë (*Carpinus orientalis* Miller.) dhe Frasheri i bardhë (*Fraxinus ornus* L.).

Ky formacion shkurror përfaqëson një fazë degradimi të pyjeve të mëparshme me Lis (*Quercus cerris* L. e *Quercus frainetto* Ten.), dominohet nga Shkoza e zezë (*Carpinus orientalis* Miller.) dhe vjen si rezultat i përdorimit tradicional për prodhimin e druve të zjarrit për nevoja familjare dhe kullotjes intensive, kryesisht nga dhite, që është dhe kafsha që menaxhohet me shume në këtë zonë. Bimësia dominohet nga specie të zakonshme bimësh që janë tipike për pyjet e dëmtuar, me diversitet të ulët specimesh. Vlera e bimësisë dhe habitatit është përgjithësisht e ulët si pasojë e diversitetit të ulët të specieve bimore dhe mungesës së specieve që konsiderohen të rralla në kontekstin lokal ose kombëtar.

Më poshtë paraqitet një pamje e këtij formacioni bimor:



Figura 6-8 Tuneli i daljes Dragobi

Me poshtë po paraqesim listën e specieve të inventarizuara.

Tabela 6-3 Tuneli i daljes, Dragobi

Tuneli i daljes, Dragobi				
Nr.	Emri i species	Forma biologjike	Forma Korologjike	Statusi i species
1	<i>Carpinus orientalis</i> Miller. (Shkoza e zezë)	Ph	Pontike	
2	<i>Fraxinus ornus</i> L. (Frasheri i bardhe)	Ph	EuMed	
3	<i>Colutea arborescens</i> L. (Fshikëkartha),	Ph	EuMed	
4	<i>Cornus mas</i> L. (Thana)	Ph	EuPont	Ushqimore
5	<i>Cotinus coggygria</i> Scop (Cërmédelli)	Ph	EuTur	Mjekesore
6	<i>Crataegus monogyna</i> (Murrizi i Heldrahit)	Ph	Paleotemp	Mjekesore
7	<i>Coronilla emerus</i> L. (Milza)	NPh	EuAsi	
8	<i>Juniperus oxycedrus</i> L. (Dellinja e kuqe)	Ph	EuMed	Mjekesore Kat. E-IUCN
9	<i>Ostrya carpinifolia</i> Scop. (Melleza)	Ph	Circumbor	
10	<i>Quercus cerris</i> L. (Qarri)	Ph	EuMed	

11	Rubus ulmifolius Schott. (Manafere)	NPh	EuMed	Ushqimore
12	Acer monspessulanum L. (Krekez)	Ph	EuMed	
13	Hedera helix L. (Urthi)	Ph	SubAtl	
14	Tamus communis L. (Pejza)	G	EuMed	
15	Brachypodium pinnatum(L.) P. Beauv. (Rudithi pendor)	H	EuAsi	
16	Buglossoides purpureocaerulea (L.) I.M. Johnston (Kokeruje mjekesore)	H	EuPont	
17	Clinopodium vulgare L. (Klinopod i rendomte)	H	Circumbor	
18	Cnidium silaifolium (Jacq.) Simonkai (Vratiku gjethesilase)	H	EuJL	
19	Cynosurus echinatus L. (Cinozuri gjembak)	T	EuMed	
20	Satureja montana L. (Trumze malesh)	Ch	MedP	Mjekesore Kat. En-IUCN VUA1c
21	Helleborus odorus L. (Shpendra)	G	EuJL	
22	Primula vulgaris Hudson. (Agulicja)	H	EuKaukaz	Mjekesore
23	Helianthemum numularum (L.) Miller (Heliantheme sarafi)	Ch	EuKaukaz	
23	Salvia argentea L. (Sherbele e argjende)	H	Med	
24	Knautia drymea Heuffel. (Knautia e dushqeve)	H	EuJL	
25	Origanum vulgare L. (Rigoni)	H	EuAsi	Mjekesore Kat. En-IUCN En A1b
26	Symphytum bulbosum C. Schimp. (Kulfime)	G	EuJL	
27	Thymus longicaulis C. Presl. (Lister)	H	EuMed	Mjekesore
28	Euphorbia cyparissias (Qumeshtorja si qiparis)	H	EuAsi	
29	Hieracium cymosum L. (Këmashën cimoze)	H	Eu	
30	Dorycnium pentaphyllum Scop. (Doriknë pesëgjethesh)	H	EuQJ	

Vegjetacioni i përshkruar është i pasur me bime mjekësore, ndërkohë që kundrejtimi Jug-Perëndimor, fenomeni shpëlarës dhe degradimi i vegjetacionit e bën atë mjaft të thate. Dominimi i bimëve fanerofite tregon se kemi të bëjmë me shpate mjaft të ngrohta e terren shkëmbor. Nga inventarizimi rezultuan tre specie të kat. E-IUCN (Libri i kuq)⁴

Këto bimë u janë bërë të njohur stafit të kompanisë ndërtimore dhe është shmangur dëmtimi i tyre duke gjat fazës së punimeve .

Analize a faktorëve të Ellenbergut paraqet pamjen e mëposhtme:

⁴ Satureja montana VUA1c dhe Origanum vulgare En A1b




Figura 6-9 Faktoret e Ellenbergut ne territorin e Tunelit te daljes Dragobi

6.5.4. Tuneli i aksesit Dragobi

Është formacioni më interesant në zonën e punimeve. Ky formacion që lokalizohet në brezin malor mesdhetar, është mjaft i përhapur në shpatet me kundrejtime veri-lindore e veri-perëndimore të pjesës së mesme të Luginës së Valbonës, në lartësitë nga 600m deri në 900m mbi nivelin e detit, në afërsi të qendrave tëbanuara.

Me poshtë paraqitet një pamje e këtij formacioni:



Figura 6-10 Formacioni bimor tek pika e aksesit te Tunelit te Dragobise

Ky vegjetacion përfaqëson pyje gjethegjera të mbizotëruara nga *Quercus petraea* (Mattuschka) Liebl. (Bunga), *Tilia cordata* L. Bliri i argjente, *Carpinus betulus* L. (Shkoza e bardhe), (*Fraxinus excelsior* L. (Frasher i zi). Popullon toka acidofile, mbi nga shkëmbinj amnor silicor.

Në këndvështrimin ekologjik përgjithësisht gjendet i instaluar në tokat më pjellore dhe më të thella. Në katin shkurror bimët kryesore janë: manaferra kreshtake (*Rubus hirtus* Ealdst. et Kit), dëllinja e zezë (*Juniperus communis* L.), qarri (*Quercus cerris* L.), thana (*Cornus mas* L.), lajthia (*Corylus avellana* L.), murrizi njëbërthamësh (*Crataegus monogyna*). Në katin barishtor paraqitet një larmi speciesh.

Ky shoqërim konsiderohet si mjaft i rëndësishëm edhe për strehimin e kafshëve të egra. Me poshtë paraqitet tabela e specieve që u inventarizuan në këtë zonë:

Tabela 6-4 Tuneli i aksesit, Dragobi

Tuneli i aksesit, Dragobi				
Nr.	Emri i species	Forma biologjike	Forma Korologjike	Statusi i species
1	<i>Quercus petraea</i> (Mat.) Lieb. (Bunga)	Ph	Eu	
2	<i>Junglans regia</i> L. (Arra)	Ph	EuAsi	Ushqimore Kat. E-IUCN
3	<i>Tilia cordata</i> Miller. (Bliri)	Ph	EuKaukaz	Mjekesore
4	<i>Corylus avellana</i> L. (Lajthia e bute)	Ph	EuKaukaz	Ushqimore
5	<i>Carpinus betulus</i> L. (Shkozebardhe)	Ph	EuKaukaz	
6	<i>Fraxinus excelsior</i> L. (Frasheri i zi)	Ph	EuKaukaz	Kat. E-IUCN
7	<i>Luzula forsteri</i> (Sm.) DC (Luzule e fosterit)	H	EuMed	
8	<i>Potentilla erecta</i> (L.) Rauschel (Potentille e ngritur)	H	EuKaukaz	
9	<i>Veronica officinalis</i> L. (Veronike mjekesore)	H	EuSib	Mjekesore
10	<i>Pteridium aquilinum</i> L. (Fier-shqipja)	G	Kozmopol	
11	<i>Veronica chamaedrys</i> (Veronike dushk-vogel)	H	EuSib	
12	<i>Lactuca muralis</i> L. (Marule e mureve)	H	EuKaukaz	
13	<i>Ajuga reptans</i> L. (Ajuge zvaritese)	H	EuAsi	
14	<i>Knautia drymeia</i> (Murb.) Borban. (Knaute dinarike)	H	EuJL	
15	<i>Primula vulgaris</i> Hudson (Agulice e rendomte)	H	EuKaukaz	
16	<i>Epilobium montanum</i> L. (Epilob malesh)	H	EuAsi	
17	<i>Anemone nemorosa</i> L. (Anemone e pyllit)	G	Circumbor	
18	<i>Rubus idaeus</i> L. Dredhes	NPh	Circumbor	Ushqimore
19	<i>Fragaria vesca</i> L. (Luleshtrydhe)	H	EuSib	Ushqimore
20	<i>Brachypodium sylvaticum</i> (Hudson) P. Beauv (Rudith pyjesh)	H	Paleotemp	
21	<i>Doronicum columnae</i> Ten. (Doronike me kolone)	G	EuKaukaz	
22	<i>Cephalanthera rubra</i> (L.) L.C.M. Richard (Cefalantere e kuqe)	G	EuAsi	
23	<i>Clinopodium vulgare</i> L. (Klinopode e rendomte)	H	Circumbor	
24	<i>Campanula persicifolia</i> L. (Lulekambane gjethepjeshke)	H	EuAsi	
25	<i>Myosotis sylvaticae</i> Hoffm. (Lulemize pyjesh)	H	Paleotemp	
26	<i>Hieracium cymosum</i> L. (Kamashen cimoze)	H	Eu	
27	<i>Melitis melisophyllum</i> L. (melithe gjethemicle)	H	SubBalk	

28	Acer obtusatum Ęaldst. & Kit. ex Ęilld. (Panje fletgjere)	Ph	EuJL	
29	Lathyrus venetus (Miller.) Ęohlfr. (Vingjer e venedikut)	G	Pontik	
30	Helleborus odorus Ęaldst.& Kit. (Shpender)	G	EuJL	
31	Asperula taurina (Pall.) Kunth (Sjerushe e Taurit)	G	EuJ	
32	Salvia glutinosa L. (Sherbele veshtulloze)	H	EuAsi	
33	Carex silvatica Hudson (Presje pyjesh)	H	EuAsi	
34	Geranium robertianum L. (Kamaroshe e Robertit)	T	SubKozmopol	
35	Euphorbia amygdaloides L.(Riell si bajame)	G	EuKaukaz	
36	Poa nemoralis L. (Flokez pyjesh)	H	Circumbor	
37	Sanicula europaea L. (Sanikula evropiane)	H	Paleotemp	
38	Trifolium pignatii Fauche & Chaub. (Terfil i Pinjatit)	G	Balk	
39	Euphrasia minima Jacq. ex DC (Eufrazia me e vogel)	T	EuCent	
40	Rhus coriaria L. (Shqeme)	Ph	Med	Mjekesore
41	Viola reichebachiana Jordan ex Boreau (Manushaqe e pyllit)	H	EuSib	

Nga inventari rezultojnë dy bime te rezikuara Kategoria E-IUCN (Libri i kuq) te cilat paraqiten ne tabelën e mësipërme.

Diagrame e faktorëve te Ellenbergut për pese speciet ndërtuese te këtij formacioni paraqitet me poshtë:




Figura 6-11 Faktorët e Ellenbergut Tuneli i aksesit Dragobi

6.5.5. Tuneli i Hyrjes Çerrem dhe pika e Marrjes

Aktiviteti ne këtë sektor konsiston ne hapjen e një rruge prej rreth 0.6 km deri ne piken e marrjes dhe hyrjen e Tunelit Çerrem.

Formacioni pyjor qe përshkon kjo rruge është një pyll ahu, qe klasifikohet ne pyjet e larte gjethegjera rënëse (LCCS3) dhe ato te pyjeve mezofile gjetherënëse (Forest Europe).

Me poshtë jepet një pamje e pyjeve te ahut te Çerremit ne zonën e punimeve:



Figura 6-12 Pyjet e ahut (*Fagus sylvatica* L.) ne hyrje te tunelit te Çerremit

Formojnë një zonë shumë të qartë në brezin me malor të rajonit të studiuar. Përfaqësojnë stadin klimaks (në ekuilibër natyror) të vegjetacionit mezofil, (700-1900m), aty ku shfaqen freskia, lagështia dhe faktorë klimatikë më të moderuar të zonës së temperuar. Përcakton një mjedis mjaft të hijezuar gjatë verës e me dritë në stinët e ftohta, përgjithësisht me akumulim të humusit të ëmbël (mull) në tokë. Ky vegjetacion shpesh copëzohet nga çeltira, e livadhe e kullota sub-alpine. Në faqet shkëmbore e me pjerrësi të madhe ai formon pykëzime duke zgjedhur vendet më të përshtatshme.

Ahishtat e zonës së Çeremit karakterizohen nga dominimi natyror i ahut (*Fagus sylvatica* L.) në katin drunor, me një kurorë-dendësi > 0.5, por në të shumtën e rasteve mbi 90%. Karakterizohen nga pak specie drunore sub-dominante, pasi ahu është intolerant ndaj specieve të tjera drunore në habitatin e tij normal, me kushte optimale klimatike e edafike. Duke përfituar nga toleranca e lartë ndaj hijes, kufijtë e habitatit të tij shtrihen nga mjediset oligotrofike deri tek eutrofiket, nga ato të lagësht deri tek të thatë e të ngrohtë, dhe nga lartësi të ulëta deri në lartësi të mëdha malore mbi nivelin e detit. Speciet drunore sub-dominante zakonisht janë në prani më të lartë në kufijtë ekologjikë të pyjeve të ahut, në areale tranzitore apo habitate më ekstreme. Si të tilla përmendim: bredhi i bardhë (*Abies alba* Mill.), hormoqi (*Picea abies*.), panja e malit (*Acer pseudoplatanus* L.), mëlleza (*Ostrya carpinifolia* Scop.), panja si rrap (*Acer platanoides* L.), shkoza e bardhë (*Carpinus betulus* L.) etj. Karakteristike për strukturën e pyjeve të ahut është prania e dy apo tre kateve bimore, me zhvillim të dobët të katit shkurror dhe barishtor, si pasojë e hijezimit, ndërsa përbërja apo mbulesa e katit barishtor është e ndryshme në varësi të nivelit të lagështisë dhe atij ushqyes të tokës, kundrejtimi i shpatit, lartësia apo pozicionigjeografik.

Speciet pjesëmarrëse të këtij formacioni jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 6-5 Hyrja e tunelit Cerem - pika e marrjes

Nr.	Emri i species	Forma biologjike	Forma Korologjike	Statusi i species
1	Fagus sylvatica L. (Ah)	Ph	EuCent	
2	Acer pseudoplatanus L. (Panje mali)	Ph	EuKaukaz	
3	Hepatica nobilis Miller.	H	Circumbor	
4	Saxifraga rotundifolia L. (Irriqez gjetherotullore)	H	EuKaukaz	
5	Sambucus nigra L. (Shtogu i zi)	Ph	EuJ	Kat. E-IUCN
6	Luzula sylvatica (Hudson) Gaudin (Luzule pyjore)	H	EuJL	
7	Lathyrus venetus (Miller.) Eöhlfr. (Vingjer e venedikut)	G	Pont	
8	Lathyrus niger (L.) Bernh (Vingjer e zeze)	G	EuKaukaz	
9	Lonicera xylosteum L. (Dorezonje druforte)	Ph	EuP	
10	Convallaria majalis L. (Lot zonje)	G	Circumbor	
11	Aremonia agrimonoides (L.) DC (Aremone si rrodhez9	H	SubKosm	
12	Lactuca muralis (L.) Gaertn. (Marule e mureve)	H	Circumbor	
13	Fragaria vesca (Luleshtrydhja)	H	EuSib	Ushqimore
14	Sanicula europaea L. (Sanikule evropiane)	H	Paleotemp	
14	Lamiastrum galeobdolon (L.) Ehrend. & Polatschek (Lamiaster galeobdolon)	H	EuKaukaz	
15	Primula veris L. (Agulice e vertete)	H	MedEuP	
16	Rubus idaeus L. (Mana toke)	NPh	Circumbor	Ushqimore
17	Daphne mezereum L. (Jargavan mali)	NPh	EuSib	
18	Cardamine bulbifera (L.) Crantz. (Kardamine me qepujke)	G	Eu	
19	Primula officinalis L. (Agulice mjekesore)	H	EuKaukaz	Mjekesore
20	Anemone nemorosa L. (Anemone e pyllit)	G	Circumbor	
21	Adiantum capillus-veneris L. (Fier i krojeve)	G	Pantropic	
22	Asplenium adiantum-nigrum L. (Fier guri i zi)	G	EuJP	
23	Veronica urticifolia Jacq. (Veronike gjethehithre)	H	EuCent	
24	Allium ursinum L. (Lerthe)	G	EuAsi	
25	Platanthera bifolia (L.) L.C.M. Richard (Platantere dygjetheze)	G	Paleotemp	
26	Galium odoratum (L) Scop. Ngjitese eremire	G	EuAsi	
27	Milium effusum L. (Mel i perhapur)	G	Circumbor	
28	Circea lutetiana L (Cirke verdhoshe)	H	Circumbor	
29	Carex sylvatica Hudson (Ptresje pyjesh)	H	EuAsi	
